



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 7.5.2026

Nr: 26

Ora: 13:30

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR PAJISJEN ME FLETË TIP PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE PËR ZHVILLIMIN E REFERENDUMIT TË PËRGJITHSHËM PËR SHFUQIZIMIN E LIGJIT NR. 20, DATË 13.3.2025 "PËR PAKETËN E MALEVE"

Sot më datë 7.5.2026, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Grupi Nismëtar për mbledhjen e nënshkrimeve për Referendum, i përbërë nga 12 anëtarë: z. Adriatik Lapaj, zj. Dorina Prethi, z. Elton Laska, zj. Edona Haklaj, zj. Agustella Thoma, z. Alfred Matoshi, z. Alban Afmeti, z. Erjon Selmani, zj. Sajmire Hoda, z. Albert Shkalla, zj. Melanika Lleshi, z. Erjon Bacaj.

OBJEKT: Kërkesë për miratimin e fillimit të procedurave për mbajtjen e referendumit për shfuqizimin e ligjit nr. 20/2025 "Për paketën e maleve".

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronjat "b" e "n", dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 150, pika 1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 126 e vijues të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Grupi Nismëtar për mbledhjen e nënshkrimeve për referendum, i përbërë nga 12 anëtarë: z. Adriatik Lapaj, zj. Dorina Prethi, z. Elton Laska, zj. Edona Haklaj, zj. Agustella Thoma, z. Alfred Matoshi, z. Alban Afmeti, z. Erjon Selmani, zj. Sajmire Hoda, z. Albert Shkalla, zj. Melanika Lleshi, z. Erjon Bacaj, shtetas shqiptarë me të drejtë vote, kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr. 1014 prot., datë 29.4.2026, për fillimin e procedurave për mbajtjen e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e ligjit nr. 20, datë 13.3.2025 "Për paketën e maleve".

Bashkëlidhur kërkesës, grupi nismëtar ka depozituar:

Data: 7.5.2026 Nr: 26
Ora: 13:30



"Për shqyrtimin e kërkesës për pajisjen me fletë tip për mbledhjen e nënshkrimeve për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e ligjit nr. 20, datë 13.3.2025 "Për paketën e maleve"

- Procesverbal mbi krijimin e grupit nismëtar për mbledhjen e nënshkrimeve për referendum.
- Kopje të kartave të identitetit të grupit nismëtar.

Referuar kërkesës, ky referendum kërkohet të zhvillohet me qëllim që qytetarët shqiptarë të shprehin drejtpërdrejt vullnetin e tyre lidhur me ligjin nr. 20, datë 13.3.2025 “Për paketën e maleve”. Ky ligj parashikon se objekti i tij është përcaktimi i procedurave, kritereve, rregullave dhe afateve procedurale për miratimin dhe zhvillimin e zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore, procedurave të kalimit të pronësisë së pronës së paluajtshme shtetërore tek poseduesit jopronarë me çmim simbolik 1 (një) euro, si dhe rregullave specifike për investitorët duke garantuar përdorimin e saj për investime të qëndrueshme dhe zhvillimin e territorit.

Sipas nismëtarëve të referendumit, në praktikë po rezulton se ligji i miratuar po nxirret nga qëllimi dhe objekti që është përcaktuar nga ligjvënësi. Sipas tyre ligji është keqpërdorur nga Kryeministri dhe organet e pushtetit vendor dhe dispozitat e tij janë nxjerrë nga qëllimi. Sipas tyre ligji është miratuar si një mundësi që kryetarët e bashkive në nivel vendor të adresojnë problematikat e atyre poseduesve jopronarë që të kthehen në pronarë të ligjshëm dhe jo zhvatjen e pronave në zonat rurale malore në favor të investitorëve të mëdhenj. Grupi nismëtar ka vijuar më tej duke sqaruar se nisur nga veprime konkrete konstatojnë se qëllimi real i ligjit është dhënia e pasurive publike të fshatrave investitorëve, duke i zhveshur banorët e fshatrave nga të drejtat e përdorimit që aktualisht kanë mbi pronat. Gjithashtu, grupi nismëtar ka parashikuar se neni 6 i ligjit ka një keqformulim të qëllimshëm i cili e devijon mekanizmin nga standardet e sigurisë juridike dhe transparencës dhe krijon hapësirë për favorizim selektiv të subjekteve, në çënim të interesit publik, të parimit të barazisë para ligjit dhe të mbrojtjes së pronës.

Në këtë kuadër, referendumi shihet si një mekanizëm demokratik i domosdoshëm për të garantuar përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimarrje për një çështje me rëndësi të veçantë shoqërore, kulturore dhe kushtetuese. Qëllimi i tij është të japë mundësinë që populli të shprehet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë mbi vlefshmërinë dhe përputhshmërinë e këtij ligji me vlerat kushtetuese, traditën juridike dhe parimet themelore të rendit kushtetues të vendit.

Në zbatim të nenit 127 të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës për referendum të përgjithshëm, pajis grupin nismëtar kundrejt pagesës me fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të 50 mijë zgjedhësve të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Zgjedhësve në kohën e paraqitjes së kërkesës. Në krye të fletës tip shtypet titulli i ligjit, dispozitat që kërkohen të shfuqizohen ose çështja që shtrohet në referendum.

Nënshkrimet në mbështetje të kërkesës për zhvillim të referendumit të përgjithshëm depozitohen në KQZ në periudhën nga 1 janari deri më 30 nëntor të çdo viti.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 126, pika 2, të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003, përpara shqyrtimit të kërkesës së paraqitur, përmbushi detyrimin ligjor për verifikimin nëse anëtarët e grupit nismëtar për zhvillimin e referendumit, figurojnë zgjedhës të regjistruar në Listën e Zgjedhësve. Konfirmohet se 12 shtetasit që figurojnë në listën e grupit nismëtar, janë të regjistruar në listën e zgjedhësve, fakt i cili përmbush kriterin e përcaktuar në nenin 126, pika 2, dhe KQZ mund të procedojë më tej me shqyrtimin e kërkesës së paraqitur.

Kërkesa e grupit nismëtar për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e ligjit nr. 20, datë 13.3.2025, “Për paketën e maleve”, përmbush kushtet e parashikuara në nenin 126 të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Grupi nismëtar është i përbërë nga numri i kërkuar ligjor i shtetasve shqiptarë me të drejtë vote, të regjistruar në listën e zgjedhësve, dhe kërkesa është shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Për rrjedhojë, vlerësohet se janë përmbushur kriteret ligjore për vijimin e procedurës referendare dhe në zbatim të dispozitave përkatëse të Kodit Zgjedhor, procedon me hapat e mëtejshëm për pajisjen e grupit nismëtar me fletët-tip për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve, në përputhje me afatet dhe rregullat e përcaktuara nga ligji.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “b” e “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 150, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 126 e vijues të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e ligjit nr. 20, datë 13.3.2025 “Për paketën e maleve”, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Afati për mbledhjen e nënshkrimeve është 8 muaj, nga data e shpalljes së këtij vendimi. Në llogaritjen e këtij afati nuk përfshihet periudha 1-31 dhjetor 2026.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sansioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 7.5.2026 Nr: 26

Ora: 13:30

Nr. Prot 1127
Dt. 08.05.2026



“Për shqyrtimin e kërkesës për pajisjen me fletë tip për mbledhjen e nënshkrimeve për zhvillimin e referendumit të përgjithshëm për shfuqizimin e ligjit nr. 20, datë 13.3.2025 “Për paketën e maleve”